



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**UDHËZUES I PËRDITËSUAR**  
**PËR MËSIMIN NË KUSHTET E SHTËPISË,**  
**PËR SHKAK TË SITUATËS SË KRIJUAR NGA PËRHAPJA E COVID-19**

Tiranë, më 30.03.2020

## **HYRJE**

Ky udhëzues<sup>1</sup> ka për qëllim të orientojë mësuesit në punën e tyre për zhvillimin e mësimit në kushtet e shtëpisë, përtej fazës fillestare dyjavore të mbylljes së shkollave për shkak të Covid-19. Në shtojcën “Materiale dhe platforma për mësimin online” listohen udhëzues, modele testesh për provimet kombëtare, platforma online si dhe video tutoriale, të cilat mbështesin mësuesit në punën e tyre.

## **QËLLIMI I MËSIMIT NË KUSHTET E SHTËPISË**

Mësimi në kushtet e shtëpisë ka për qëllim t’i mbajë nxënësit të angazhuar me përmbajtjen lëndore dhe përforcimin e njohurive të fituara deri tani për të mos u shpëputur nga procesi i të nxënësve, deri në rifillimin e procesit mësimor të rregullt.

---

<sup>1</sup> Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, të Urdhrit të MASR-së, nr. 591, datë 09.03.2020, “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”, të Urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.190, datë 19.03.2020, “Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID – 2019”.

## 1. DPAP-ja, DRAP-të dhe ZVAP-të

- informojnë dhe shpërndajnë në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha shkollat çdo udhëzim dhe urdhër të MASR-së;
- sqarojnë drejtuesit e shkollave për format e ndryshme të mësimin në kushtet e shtëpisë (*WhatsApp, e-mail, platforma online, facebook, skype, video* etj.);
- **përshtatin mësimin në kushtet e shtëpisë në varësi të specifikave të zonës së tyre;**
- organizojnë online shërbimin psiko-social për nxënësit dhe mësuesit, organizojnë pyetësorë me prindër dhe fëmijë për të mbledhur të dhëna dhe për të vlerësuar informacionin se si fëmijët po e përballojnë periudhën e izolimit dhe distancimin social, përmes këndit të psikologut të krijuar për çdo DRAP, sipas linqeve të mëposhtme:
  - Durrës: <http://durrres.arsimiparauniversitar.gov.al/kendi-i-psikologut/>
  - Lezhë: <http://lezhe.arsimiparauniversitar.gov.al/kendi-i-psikologut/>
  - Fier: <http://fier.arsimiparauniversitar.gov.al/kendi-i-psikologut/>
  - Korçë: <http://korce.arsimiparauniversitar.gov.al/kendi-i-psikologut/>
- publikojnë në web-in zyrtar udhëzues dhe materiale që dalin nga MASR, ASCAP dhe DPAP;
- informojnë MASR-në lidhur me ecurinë e zhvillimit të mësimin në kushtet e shtëpisë.

## 2. DREJTORITË E SHKOLLAVE

- shkëmbejnë informacione nga burime zyrtare për COVID-19 dhe të mos ndikohen nga emocionet negative që shkaktohen nga keqinformimi, pasiguria dhe paniku;
- konsolidojnë formën dhe mënyrën e komunikimit në grup të mësuesit me nxënësit dhe prindërit e tyre (*WhatsApp, e-mail, platforma online, facebook, skype, video* etj.);
- hartojnë një plan pune (kalendar) ku përcaktojnë:
  - përmbajtjet mësimore që mësuesit do t'u rekomandojnë nxënësve (sipas specifikave të lëndëve), bazuar në programin mësimor dhe në planifikimin e periudhës;

- orarin e komunikimit të mësuesve me prindërit e nxënësve dhe me nxënësit e tyre: **orari të jetë i përshtatshëm edhe për prindërit, në mënyrë që të mos jenë të angazhuar gjithë ditën;**
- plan të veçantë për nxënësit e klasës V, duke u fokusuar në lëndët e gjuhës shqipe, matematikës dhe dituri natyrës;
- plan të veçantë për nxënësit e klasës IX, duke u fokusuar në lëndët që janë provime kombëtare të arsimit bazë;
- **plan të veçantë për nxënësit maturantë**, duke u fokusuar në lëndët që janë provime të detyruara si dhe në lëndën që nxënësit kanë zgjedhur si provim me zgjedhje;
- bëjnë kujdes që në planet e tyre të punës për zhvillimin e mësimit në kushtet e shtëpisë ditët e pushimit zyrtar të jenë të lira për mësuesit dhe prindërit. Kjo nënkupton që gjatë ditëve të pushimit (përfshirë fundjavat dhe ditët e pushimit zyrtar) mësuesit nuk do të komunikojnë online me prindërit dhe anasjelltas. Komunikimi i tyre për zhvillimin e mësimit në kushtet e shtëpisë do të jetë vetëm në ditët zyrtare që janë mësim, për të mos mbingarkuar punën e mësuesit dhe punën e prindërve, ashtu siç veprohet gjatë mësimit në shkollë;
- publikojnë në web-in e shkollës përmbajtjet mësimore (*video-selfie*) të rekomanduara nga mësuesit, udhëzues dhe materiale që dalin nga MARS, ASCAP dhe DPAP;
- informojnë ZVAP-në përkatëse lidhur me ecurinë e zhvillimit të mësimit në kushtet e shtëpisë.

### 3. MËSUESI

- komunikon rregullisht me nxënësit dhe prindërit e tyre dhe me drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësimet edhe në kushtet e shtëpisë;
- zbaton planin e punës (kalendarin) të hartuar nga drejtoria e shkollës sipas klasave dhe përmbajtjes mësimore;
- zgjedh formën dhe mënyrën e komunikimit në grup me nxënësit dhe prindërit e tyre (*WhatsApp, e-mail, platforma online, facebook, skype, video* etj.) për komunikimin e përmbajtjeve mësimore, P.sh.: Një mësues rekomandon që: *“Për çdo klasë të hapet një grup në facebook ku mësuesi të jetë administrator i faqes ose një nxënës i zgjedhur si*

*moderator i grupit. Postimet, para se të bëhen publike në grup, të miratohen nga mësuesi si administrator i grupit. Mësuesi poston video ose një material për çdo mësim. Nxënësit mund të bëjnë pyetje rreth mësimit ose të postojnë detyrat”.*

Një formë komunikimi mund të jetë edhe biseda telefonike, në rastet kur nuk mund të realizohet komunikimi nëpërmjet internetit;

- përcakton përmbajtje mësimore (*video-selfie*) që do t'u rekomandojnë nxënësve duke respektuar planin mësimor të lëndës për klasën përkatëse;
- jep udhëzime në grupin e krijuar në lidhje me përvetësimin e përmbajtjes mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura prej tij;
- u përgjigjet pyetjeve që i adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen mësimore;
- jep detyra, ushtrime, lexime plotësuese, kuizze etj. për përmbajtjen mësimore përkatëse në varësi të specifikave të secilës lëndë;
- **bën kujdes të mos mbingarkojë nxënësit me përmbajtjen mësimore** duke u fokusuar në njohuritë kryesore dhe përforcimin e njohurive të fituara deri tani;
- **organizon orarin e mësimit në kushtet e shtëpisë dhe komunikimin online me nxënësit dhe prindërit në kohën e përshtatshme për mësuesin dhe për prindërit**, në mënyrë që të mos krijohet mbingarkesë dhe prindërit të mos jenë të angazhuar gjatë gjithë ditës, si dhe duke qenë fleksibël në përshtatje me klasën dhe përmbajtjen mësimore;
- mund të presë detyra që i përcjellin nxënësit gjatë fundjavës, por nuk komunikon me ta;
- informon drejtorinë e shkollës lidhur me ecurinë e zhvillimit të mësimit në kushtet e shtëpisë.

#### 4. NXËNËSIT

- angazhohen për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e tyre;
- studiojnë pjesë të tekstit mësimor, bëjnë shënime në fletoret e tyre dhe u përgjigjen pyetjeve të dërguara nga mësuesi;
- u adresojnë pyetje mësuesve të tyre për vështirësitë dhe paqartësitë që mund të kenë në lidhje me përmbajtjet mësimore të rekomanduara;
- ndjekin videot dhe përmbajtjet mësimore online të sugjeruara nga mësuesit e tyre;

- mund të dërgojnë detyra/ushtrime/punime të ndryshme të kryera prej tyre gjatë periudhës së qëndrimit në shtëpi për të marrë komente nga mësuesi dhe nxënësit e tjerë;
- mund të kryejnë detyra apo të ndjekin ritransmetimet e përmbajtjeve mësimore në RTSh gjatë fundjavës, por nuk komunikojnë me mësuesit;
- lexojnë libra artistikë/enciklopedikë/publicistikë për moshën përkatëse, të sugjeruara nga mësuesit e tyre.

## **5. PRINDËRIT**

- të jenë pjesë e grupeve të komunikimit me mësuesit sipas planit të përcaktuar nga drejtoria e shkollës;
- të marrin çdo informacion që vjen nga drejtoria e shkollës dhe mësuesit përkatës;
- të mbështesin fëmijën në mësimin në kushtet e shtëpisë duke lehtësuar marrjen e informacionit nga mësuesit.

## **6. MATURANTËT**

Qendra e Shërbimeve Arsimore ka publikuar në faqen e saj të internetit dy botime, të cilat i gjeni në linkun më poshtë:

Libri “Matura Shtetërore Gjuha Shqipe dhe Letërsia” është një përmbledhje e testeve të Maturës Shtetërore për Gjuhën Shqipe dhe Letërsinë për vitet 2011-2019. Përmes këtij botimi, QShA synon t’iu vijë në ndihmë maturantëve dhe mësuesve për t’u familjarizuar me natyrën e testeve dhe të pyetjeve që përdoren në testin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë të Maturës Shtetërore. Në material do të paraqiten edhe disa orientime mbi natyrën e testeve.

[http://qsha.gov.al/infos/gjuhe\\_shqipe.pdf](http://qsha.gov.al/infos/gjuhe_shqipe.pdf)

Libri “Matura Shtetërore 2019, teste dhe skema vlerësimi, gjuhët e huaja, matematika dhe lëndë me zgjedhje (për gjimnazin)” përmban testet e provimeve të Maturës Shtetërore 2019, për gjuhën

e huaj, matematikën, dhe lëndët me zgjedhje, të shoqëruara bashkë me skemat e vlerësimit. Në material do të paraqiten edhe disa orientime mbi natyrën e testeve.

[http://www.qsha.gov.al/infos/matematike\\_lende\\_zgjedhje\\_gjuhe\\_huaj.pdf](http://www.qsha.gov.al/infos/matematike_lende_zgjedhje_gjuhe_huaj.pdf)

**Gjatë zhvillimit të mësimit në kushtet e shtëpisë për periudhën në vazhdim, sugjerohet që maturantët të punojnë me materialet e mësipërme, duke u fokusuar në lëndët që janë provime të detyruara dhe në lëndën që kanë provim me zgjedhje.**

Disa këshilla në ndihmë të maturantëve për përgatitjet për provimin e MSh-së 2020 në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë:

Gjatë periudhës së ndërprerjes së procesit mësimor, është e nevojshme që maturantët:

- të rifreskojnë njohuritë që lidhen me tekstet joletrare, duke u fokusuar më shumë në ato *përshkruese* dhe *argumentuese*, për shkak të peshës që zënë në Programin Orientues të Maturës Shtetërore 2020. Gjatë përsëritjes, ata duhet të përforcojnë njohuritë që lidhen me analizat e tekstit joletrar nga pikëpamja e:
  - përmbajtjes ideore;
  - strukturës dhe teknikave të shkrimit;
  - aspektit gjuhësor.
- të përpiqen të shkruajnë në mënyrë të pavarur 4 ese në javë, me **tema esesh** që paraqiten në rubrikat: **të shkruajmë**, në tekstet me të cilat punojnë maturantët në shkollat e tyre.
- të rifreskojnë njohuritë që lidhen me tekstin letrar sipas planifikimit të mëposhtëm:
- për autorët si: *Homeri, Eskili, Aligeri, Shekspir, Gëte, Hygo, De Rada, Balzak* (të cilët janë studiuar gjatë viteve të shkollimit), mund të realizohet përsëritja e plotë e tyre;
- për autorët si: *Kamy, Migjeni, Poradeci, Agolli, Kadare, Shkreli*, maturantët është mirë të përsëritin njohuritë që lidhen me autorët që kanë studiuar deri tani në shkollë
- të ushtrohen me modele testesh dhe esesh të viteve të kaluara, të përfshira në librin “Matura Shtetërore Gjuha Shqipe dhe Letërsia”, në mënyrë që të familjarizohen edhe me mënyrën e vlerësimit të esesë.

Disa këshilla në ndihmë të maturantëve për përgatitjet për provimin e MSh-së 2020 në lëndën e matematikës:

Gjatë periudhës së ndërprerjes së procesit mësimor, udhëzojmë që maturantët, të ushtrohen me tematikat kryesore më poshtë, nisur edhe nga pesha e madhe që ato kanë në programin orientues të MSh-së:

- numri;
- matja;
- gjeometria;
- algjebra dhe funksioni;
- probabiliteti dhe statistika.

Është e nevojshme që maturantët të ushtrohen në zgjidhje ushtrimesh sipas tipeve të mëposhtme:

- ushtrime që vlerësojnë vlefshmërinë e një argumenti matematikor në një situatë problemore kryesisht nga tematika e algjebërës dhe funksionit;
- ushtrime ku kërkohet paraqitja e informacionit matematikor;
- ushtrime me alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat e dhëna);
- ushtrime për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në një situatë të dhënë nga jeta reale, (kjo vlen për të gjitha tematikat sipas programit orientues);
- ushtrime ku maturanti ndërton zinxhirin e arsytimeve dhe interpretimin e hapave të ndjekura për zgjidhjen e një situatë problemore.

Njëkohësisht, maturantët mund të ushtrohen me modele testesh të përfshira në librin “Matura Shtetërore 2019, teste dhe skema vlerësimi, gjuhët e huaja, matematika dhe lëndë me zgjedhje (për gjimnazin)”, në mënyrë që të familjarizohen me natyrën e pyetjeve.



## **7. SHTOJCA**

### **MATERIALE DHE PLATFORMA PËR MËSIMIN ONLINE**

#### **UDHËZUES DHE URDHRA**

Udhëzues për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19 – Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

[https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Udhezues-per-dy-javet-epezullimit-te-mesimit\\_Mars-20201.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Udhezues-per-dy-javet-epezullimit-te-mesimit_Mars-20201.pdf)

Udhëzues për realizimin e programit lëndor dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mëimit në kushtet e shtëpisë (ASCAP)

[https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Udhezues-vleresimi-ne-kushte-teshtepise\\_.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Udhezues-vleresimi-ne-kushte-teshtepise_.pdf)

Urdhër për funksionimin e shërbimit psiko-social në kushtet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore (DPAP)

<http://arsimiparauniversitar.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/URDHER-NR.111-DATE-26.03.2020-PER-FUNKSIONIMIN-E-SHERBIMIT-PSIKO-SOCIAL-NE-KUSHTET-E-SHPALLJES-SE-GJENDJES-SE-FATKEQSISE-NATYRORE.pdf>

#### **MODELE TESTESH PËR PROVIMET KOMBËTARE**

Matura Shtetërore, Gjuha Shqipe dhe Letërsia (QSHA)

[http://qsha.gov.al/infos/gjuhe\\_shqipe.pdf](http://qsha.gov.al/infos/gjuhe_shqipe.pdf)

Matura Shtetërore 2019, teste dhe skema vlerësimi, gjuhët e huaja, matematika dhe lëndë me zgjedhje (QSHA)

[http://www.qsha.gov.al/infos/matematike\\_lende\\_zgjedhje\\_gjuhe\\_huaj.pdf](http://www.qsha.gov.al/infos/matematike_lende_zgjedhje_gjuhe_huaj.pdf)

Udhëzuesi dhe modeli i pyetjeve për provimet kombëtare të arsimit bazë për klasën e IX-të (QSHA)

[http://qsha.gov.al/infos/gjuhe\\_shqipe\\_matematike\\_pkab.pdf](http://qsha.gov.al/infos/gjuhe_shqipe_matematike_pkab.pdf)

Udhëzuesi dhe Modeli i pyetjeve për provimet kombëtare të arsimit bazë; Gjuha e huaj, Anglisht, Italisht, Frëngjisht, Gjermanisht (QSHA)

[http://qsha.gov.al/infos/gjuhe\\_huaj\\_pkab.pdf](http://qsha.gov.al/infos/gjuhe_huaj_pkab.pdf)

Modelet e testeve dhe skemat e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor (QSHA)

[http://qsha.gov.al/infos/modele\\_skema\\_kl5.pdf](http://qsha.gov.al/infos/modele_skema_kl5.pdf)

## **PLATFORMA ONLINE**

Kanali i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në youtube

[https://www.youtube.com/channel/UC21Y6wkN3En\\_HKFdt4yWxMQ](https://www.youtube.com/channel/UC21Y6wkN3En_HKFdt4yWxMQ)

Platforma Akademi.al

<https://www.akademi.al/signup/>

Platforma kursori.org

[https://kursori.org/?fbclid=I%3C%ABAR3Co5Dq9AFH1RnBc1wgGHVR2agZ6ccdW5Wp%20Hn%20R2U4P6\\_\\_-IGFk\\_PWJAtME](https://kursori.org/?fbclid=I%3C%ABAR3Co5Dq9AFH1RnBc1wgGHVR2agZ6ccdW5Wp%20Hn%20R2U4P6__-IGFk_PWJAtME)

Platforma Google Classroom

[https://edu.google.com/products/classroom/?modal\\_active=none](https://edu.google.com/products/classroom/?modal_active=none)

Platforma Zoom

<https://blog.zoom.us/wordpress/2020/03/29/how-to-use-zoom-for-online-learning/>

Platforma Edmodo

<https://new.edmodo.com/?go2url=%2Fhome>

Platforma të tjera (UNESCO)

<https://en.unesco.org/themes/education-emergencies/coronavirus-schoolclosures/solutions>

## **TUTORIALE**

Krijimi i klasave virtuale në Google Classroom

<https://www.youtube.com/watch?v=o114seNJGDE&feature=youtu.be>

Si të krijomë një klasë në internet me platformën Edmodo

[https://www.youtube.com/watch?v=v8Vnj8shxsl&list=PLKdJcyIMiwzpZVxY6Kb%20vu%20k2db\\_jecP2su&index=4&t=0s](https://www.youtube.com/watch?v=v8Vnj8shxsl&list=PLKdJcyIMiwzpZVxY6Kb%20vu%20k2db_jecP2su&index=4&t=0s)